



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 54/Prot.

Pogradec, më 06.12.2021

VENDIM

NR. 108, DATË 02.12.2021

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË, PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES  
NGA FONDI PYJOR PUBLIK, TË SIPËRFAQES PYJORE PREJ 37,93  
(TRIDHJETE E SHTATË PRESJE NENTEDHJETE E TRE) HA, E NDODHUR NË  
EKONOMINË PYJORE MOKËR 2, PËR SHFRYTËZIMIN ME KARRIERË TË  
MINERALIT HEKUR-NIKEL, NË ZONËN MINERARE BARI I BARDHË  
(DEBROVË), NGA SHOQËRIA "JOAL-06" SHPK.**

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, shkronjës "e" të nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Ligjit Nr.10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minierar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, dhe ishkomunave/bashkive", shkronjës "ç" të pikës 5 të Vendimit Nr.1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave. "Për përcaktimin e rregullave dhe për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor publik", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Mjedisit nr. 7806/1, datë 15.12.2020 "Për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor", Urdhërit nr. 06, datë 07.01.2021, "Mbi hartimin e raportit tekniko-ekonomik, për heqjen nga fondi pyjor/kullosor në pronësi të bashkisë", i ndryshuar me Urdhërin Nr. 224, datë 19.04.2021, si dhe bazuar në Raporti "Mbi studimin tekniko – ekonomik, për heqjen nga donsi pyjor të sipërfaqes prej 37.93 Ha, në ekonominë pyjore Moker 2, në pronësi të Bashkisë Pogradec, "Për shfrytëzimin e mineralit të Hekur

– Nikelit në objektin Bari i Bardhë (Debrovë) dhe shtojcave bashkëngjitur, bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

## KËSHILLI I BASHKISË

### VENDOSI :

1.Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik, të sipërfaqes pyjore prej 37,93 (tridhjetë e shtatë presje nentedhjetë e tre) Ha, e ndodhur në Ekonominë Pyjore Mokër 2, për shfrytëzimin me karrierë të mineralit hekur-nikel, në zonën minerare “Bari i Bardhë” (Debrovë), nga shoqëria “Joal-06” shpk, në ngastrat të pasqyruara si më poshtë vijon:

ID Pronës	Përdorimi	Ekonomia pyjore	Parcela	Sip.totale në/ha
KO50 0 039	Pyll	Moker 2	39a	8.00
KO50 0 039	Pyll	Moker 2	39c	23.43
KO50 0 040	Pyll	Moker 2	40c	0.35
KO50 0 041	Pyll	Moker 2	41a	6.15
<b>SHUMA:</b>				<b>37.93</b>

2.Shoqëria Joal-06 SHPK, detyrohet të paguajë për llogari të Bashkisë Pogradec vlerën prej 387 050 (Treqind e tetëdhjetë e shtate mije e pesëdhjetë) Lekë.

3.Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore të sipërcituara dhe sigurimin e të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Pogradec.

4.Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, Sektori i Shërbimit Pyjor pranë Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

5.Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data eshpalljes.

6.U shpall sot më datë \_\_\_\_\_.2021.

K R Y E T A R

Sotiraq MANGËRI

